

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 10 MARS 2022

Zonja drejtuese e seancës,

Të dashur qytetarë dhe qytetare, që ndiqni këtë seancë,

Zonja dhe zotërinj,

Para së gjithash, unë dua të dënoj, me forcën më të madhe, nga platforma e këtij parlamenti, infanticidin e forcave barbare të diktatorit rus, diktatorit gjakësor, të cilat kanë ushtruar dhunë dhe në qytetin e Mariupolit, duke bombarduar një spital fëmijësh dhe maternitetin. Ky akt, që është një krim dhe gjenocid i vërtetë, krim i egër kundër njerëzimit, dëshmon edhe një herë më së miri fytyrën e diktatorit gjakësor rus, i cili, ndër të tjera, në mënyra direkte, ka lëshuar edhe kërcënime ndaj Shqipërisë, siç ka bërë në telefonatën me kancelarin Sholc, por edhe përpara kësaj, ai dhe ministri i Jashtëm kanë lakuar emrin e shqiptarëve dhe të Shqipërisë. Me këtë rast, dua t'i themi këtij diktatori barbar se urrejtja patologjike ndaj shqiptarëve nuk është e habitshme, është vazhdim i asaj politike shekullore që Rusia ka ndjekur ndaj kombit shqiptar.

Zonja dhe zotërinj,

Sot këtu u paraqitën 2 raporte, të dyja të lidhura me aferën më të madhe korruptive të dokumentuar deri sot, siç është afera e inceneratorëve. Për t'u përshëndetur është fakti se të dyja këto raporte faktojnë në mënyrë të padiskutueshme vjedhjet e pamohueshme. Njëri prej raporteve fakton vjedhjen e 420 milionë eurove dhe më shumë, raporti tjetër pohon më së fundmi se s'bëhet fjalë për 420 milionë euro, por gjithsej për 100 milionë dhe kjo u duket pak.

Të nderuar qytetarë dhe qytetare,

Keni dëgjuar gjatë zhvillimit të punimeve të këtij komisioni dëshmi të shumta, pohime të gënjeshtërtë, strukje të hajdutëve, por mbi të gjitha në këtë komision, mendoj se pohimi i njeriut me përgjegjësi absolute kryesore në këtë aferë dhe në ndarjen e parave, aferë e cila është tërësisht e një grupi kriminal të organizuar, pohimi i Edi Ramës se ka shkelur ligjin apo nuk ka respektuar procedurën, është çelësi për të kuptuar gjithçka, për të zbërthyer plotësisht këtë aferë. Më thjesht, po rikujtoj këtu se afera filloi në vitin 2014 me një kompani që kurrë nuk ishte marrë me plehrat, as me djegësit, por që pretendonte të ishte e Zotos, e Gugalljas e të tjerëve, por, në fakt, ishte strikt e qeveritarëve. Kësaj kompanie, me një procedurë të rrufeshme, të pashembullt në historinë e këtij shteti, duke firmosur 17 dokumente në 24 orë, me negociim, pa shpallje, pa tender, pra me korrupsion të sigurt, i jepen 22 milionë euro për djegësin e Elbasanit dhe kompania, që mund ta quajmë "Ahmetaj", "Gjiknuri"; mund ta quajmë "Rama", "Agaçi"; mund ta quajmë "Metani" e të tjerë, prokuron në Lugano një djegës, e instalon atë me çelësa në dorë për 12 milionë euro. Pra, 10 milionë euro ngelen në llogaritë e qeveritarëve që vepruan në mënyrë të rrufeshme. Ju fare mirë mund të më pyesni: përse thua të qeveritarëve, ku i ke dokumentet?

Kjo s'mund të bëhej kurrë pa firmën, pa vulën dhe angazhimin total e të gjithë fuqisë së qeverisë. Nëse qeveritarët nuk donin të vidhnin e të ndanin paratë, këtë fond ia kalonin Bashkisë së Elbasanit, e cila hapte tenderin, instalonte inceneratorin dhe u kursente taksapaguesve shqiptarë 12 milionë euro. Të mos mendojë kush që ky 12 milionë eurosh iu la me gjenerozitet Stela Gugalljas, Klodian Zotos apo Mërtirit. Jo, absolutisht, këto iu lanë strikt qeveritarëve. Oreksi vjen duke ngrënë.

Kjo skemë u përsërit me Fierin, i cili u kalua në 30 milionë dhe ajo që mbeti në kontot e qeveritarëve, jashtë çdo procedure, përsëri me negociim, pa shpallje, pra fitimi, kaloi në 15 milionë dhe pastaj vrapuan drejt Tiranës. Këtu komisioni ndahet: ata që pranojnë se vodhën 100 milionë, ata sulmojnë. Ku janë 420 milionë, na thoni, ku janë? Për 100 milionë nuk kanë vërejtje, por jua them unë se ku janë. Në Tiranë është vjedhur më me stil. Që nuk ka asnjë incenerator në punë, kjo është e sigurt, por në Tiranë si është vjedhur? Fusha e Sharrës, e cila ishte një ndërmarrje publike, në të cilën prej 25 vjetësh depozitoheshin plehra, një mëngjes, nga kompani publike e Bashkisë së Tiranës, bëhet kompani "Gugallja" e Erion Veliajt. Këtu fillon vjedhja e qytetarëve të Tiranës dhe të Durrësit. Tani fillon gjoba, tani fillon sharra të presë flori për Edi Ramën. Çdo ton mbetje, dhe zhavorr, çfarëdo që të jetë, do të depozitohet në Sharrë, duke i paguar kompanisë së Veliajt, me emrin "Gugallja", me 28 euro për ton.

Të dashur qytetarë,

Do të ndërtohej me 128 milionë djegësi, duke paguar si për djegien kur ato kompostoheshin dhe nuk digjeshin 28 euro për ton. Pra, kemi të bëjmë me një skemë klasike vjedhjeje. E vërteta është se aktakuza e ngritur ndaj Lefter Kokës, hajdutit të dobishëm, është 100% e përshtatshme për kreun e "Meduzës", për Engjëll Agaçin, për Arben Ahmetajn, për Damian Gjinkurin dhe për Erion Veliajn. Pra, kjo është historia e kësaj afere.